

BULETIN INFORMATIV

Realizuar në kuadrin e projektit “Fuqizimi i kapacitetve të shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”

PUNOJMË SË BASHKU PËR TË REALIZUAR NJË SHKOLLË GJITHËPËRFSHIRËSE.



Çdo fëmijë është si lulët e një kopshti që ndryshojnë nga tjetra, por në unitet e bëjnë botën një kopsht më të bukur. Ashtu dhe gjithëpërfshirja është një mënyrë për ta bërë botën më të mirë për secilin prej nesh!

Nëse ne bashkohemi të gjithë, ky është vetëm një fillim, nëse vazhdojmë të qëndrojmë është një progres, por nëse punojmë të gjithë së bashku, padyshim që ky është një sukses.

Të bashkojmë zërin tonë për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës, të japim kontributin tonë për të mbështetur arsimimin e bashkëmoshatarëve tanë me aftësi të kufizuara.

Gjithëpërfshirja është një e drejtë, jo një privilegj!

Në kuadrin e projektit, krahas veprimtarive të tjera, është punuar ngushtësisht me qeveritë e nxënësve të 5 shkollave të projektit me qëllim nxitjen e iniciativave të tyre për promovimin e gjithëpërfshirjes dhe fuqizimin e këtyre strukturave të rëndësishme.

Qeveria e nxënësve duhet të vlerësohet dhe të mbështetet nga të gjithë. Mësuesit, drejtuesit e shkollës, prindërit dhe nxënësit, duhet të kuptojnë rëndësinë e qeverisë së nxënësve në shkollë si dhe përfitimet që ka gjithë komuniteti shkollor nga puna e mirë e saj!

Mjedisi i shkollës përmirësohet kur nxënësit kanë idetë e tyre për të sjellë ndryshime dhe bashkëpunojnë me aktorë të ndryshëm për t'i realizuar ndryshimet. Komuniteti përmirësohet kur qeveritë e nxënësve angazhohen për çështje të ndryshme, përfshirë edhe përkujdesjen ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për ndihmë për të rritur vetëbesimin dhe në aftësitë e tyre.

Në kuadrin e projektit “Fuqizimi i kapacitetve të shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, secila prej qeverive të nxënësve të shkollave “*Sul Misiri*” në Elbasan, shkolla 9-vjeçare *Shushicë*, shkolla 9-vjeçare “*Xhemali Plaka*” në Gostimë, shkolla “*A.Leshnjaku*”, *Bradashesh*, shkolla 9-vjeçare *Muriqan* kanë paraqitur mini-projekte të cilat janë mbështetur nga MEDPAK. Një përmbledhje e këtyre iniciativave paraqitet më poshtë.

Në shkollën 9-vjeçare *Shushicë* u organizua aktiviteti “Ne jemi miq të librit”, qëllimi i të cilit ishte edukimi i nxënësve me dëshirën

për librin dhe leximin. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me Drejtorinë së shkollës, Qeverinë e Nxënësve, Klubit të krijuesve letrarë, Bordit të shkollës dhe prindërve. Një nga objektivat kryesore të këtij aktiviteti ishte edhe përfshirja e fëmijëve që vijnë nga grupe të marxhinalizuara, përfshirë dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Një prej arritjeve të këtij projekti ishte rritja e numrit të këtyre fëmijëve, që anëtarësohen në Bibliotekën e shkollës. Aktiviteti vijoi me konkursin “Interpretuesi më i mirë” dhe në përfundim të këtij aktiviteti MEDPAK dhuroi një fond librash për pasurimin e Bibliotekës së Shkollës.



“Fëmijët mësojnë më shumë prej asaj çfarë ju bëni, sesa nga ajo çfarë u mësoni”

Qeveria e nxënësve e shkollës 9-vjecare “Xhemali Plaka” në Gostimë, ishte shumë aktive në realizimin e aktiviteteve të projektit. Një prej veprimtarive më efektive të ndërmarra nga shkolla ishte mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Nxënësit vullnetarisht bëhen pjesë e grupeve të patronazhit, për

të ndihmuar shokët e tyre me nevoja të vecanta në edukim. Një prej aktiviteteve më të spikatura ishte aktiviteti i bamirësisë, që synoi mbledhjen e ndihmave në vlerë monetare e veshmbathje të cilat shkuan në ndihmë të shokëve dhe familjeve të tyre.



Kjo iniciativë erdhi si ide e nxënësve për shkak të një vlerësimi fillestar të gjendjes social-ekonomike të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një tjetër iniciativë që pasoi të parën, ishte organizimi i një panairi me produkte nga fusha e gastronomisë, tekstilit, dhe pikturave të cilat u ofruan për shitje. Me fondet e mbledhura u mbështetën përsëri familjet e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Qeveria e nxënësve të shkollës "A.Leshnjaku", Bradashesh organizoi disa aktivitete me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit për të drejtat e fëmijëve apo personave që u përkasin grupeve vulnerabël. Në fokus të tyre, kanë qenë aktivitetet për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara të Qendrës së Rehabilitimit të grave Balashe dhe fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Elbasan.

Nxënësit i përshkruan si përvoja shumë të bukura dhe të papërsëritshme për nga emocionet. Mesazhi i një prej nxënësve ishte *"përfituesit e vërtetë të këtyre vizitave ishim vetë ne"*.

Duke e parë me sytë e tyre dhimbjen, nevojën për mbështetje,

pranim, e më shumë vëmendje, nxënësit u ndërgjegjësuam për të ndërmarrë veprimtari të tjera humanitare.



Në shkollën 9 - vjeçare “Sulë Misiri” u zhvilluan një sërë aktivitete me qëllim sensibilizimin e komunitetit shkollor dhe më gjerë.



Nxënësit u angazhuan për të formuluar mesazhe domethënëse të cilat u stampuan tek bluzat. Vizatime dhe piktura me fokus gjithëpërfshirjen u punuan për t’u vendosur në këndet e klasave. Përgatitja e mesazheve zanore me fjalët e zemrës të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe bashkëmoshatarëve të tyre ishte një tjetër ide interesante. Këto mesazhe ishin edhe në formën e një videoje, që u trasmetua në shkollë, si dhe gjatë aktivitetit me Qeverite e Nxënësve.

Finalizimi i këtij cikli aktivitetesh ishte në mënyrën me origjinale, duke mbjelle disa pemë në oborrin e shkollës ku secila prej tyre simbolikisht përfaqësonte virtyte të larta njerëzore si përkujdesje, përkushtim, pranim, solidaritet etj.



Projekti i shkollës Muriqan konsistoi në realizimin e një teatri kukullash ku përmes improvizimit të situatave nga jeta reale të rritej ndërgjegjësimi në lidhje me të drejtat e njeriut dhe veçanërisht të fëmijëve, por edhe për të zbuluar talentet e nxënësve në aktrim.



Si “qeveritarë” të së ardhmes, të gjithë këta fëmijë janë më të vetëdijshëm për shërbimet që duhet të krijojnë, politikat efektive dhe ndryshimin e qëndrimeve dhe kulturave ndaj komuniteteve në nevojë!



**Ndërgjegjësimi është agjenti më i fuqishëm i ndryshimit!
Një person me nevoja speciale, ju bën ju të jeni një njeri special!**

ARRITJET E PROJEKTIT

- ❖ Janë rritur kapacitetet e grupeve për advokim të vazhdueshëm, për të kërkuar zbatimin e ligjit nisur nga praktikat më të mira të ngritura tani në rajonet e Elbasanit dhe Dibrës.
- ❖ Janë përmirësuar ndjeshëm aftësitë e qeverisë së nxënësve për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- ❖ Prindër, mësues, nxënës dhe aktorë të tjerë të shkollës janë informuar dhe kanë rritur kapacitetet për zbatimin e ligjit të Arsimit Parauniversitar me synim ndërtimin e shkollave gjithëpërfshirëse .

Realizuar në kuadrin e projektit “Fuqizimi i kapacitetve të shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Shqipëri”



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon

Pali II, kati i 17-të, Tiranë – Albania

Telefon: (+355) 4 222 8320 or 223 0871

Fax: (+355) 4 223 0752

E-mail: delegation-albania@eeas.europa.eu

